



REPUBLIKA E SHQI
AVOKATI I POPU
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800125/5

Tiranë ___/___/2018

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave për vendosjen e emërit të Dëshmorit të Atdheut, të H. K. K., një objekti ose një institucioni arsimor në qytetin e Shkodrës.*

Drejtuar : **Z. XHEMAL BUSHATI**
Kryetar i Këshillit Bashkiak Bashkia Shkodër

SHKODËR

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e saj datë 22.01.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, Zj. Erinda BALLANCA, shtetësja M. K. me banim në Lagjen "Luigj Gurakuqi", Pallati Nr.74 në qytetin e Elbasanit, ish bashkëshorte e "Dëshmorit të Atdheut" H. K. K., i cili gjatë vitit 1990, ka punuar në radhët e Policisë së Shtetit në qytetin e Shkodrës dhe me datën 23.08.1990, ai është vrarë dhe ka rënë krye të detyrës nga persona keqëbërës të cilët janë gjykuar dhe dënuar në bazë të legjislacionit në fuqi.

Me vendimin Nr.717 datë 11.01.2017 ai është shpallur "Dëshmor i Atdheut", nga Komisioni Qëndror i Statusit "Dëshmor i Atdheut", dhe nga ana e saj ankuesja M.K. na sqaron se i ka bërë kërkesë me shkrim Këshillit Bashkiak Shkodër, që emëri i tij të kujtohet dhe respektohet duke ju vënë emëri i tij, një Shkolle, Kopshti ose Rruge si ta shikojë të arsyeshme Këshilli Bashkiak i Bashkisë së qytetit Shkodër.

Ankuesja nga ana e saj na ka sqaruar se i nderi H. K. K. ka qënë nga fshati Dajç, Bregu i Bunës të Rrethit Shkodër, ai ka shërbyer për 8 vjet në radhët e Policisë Shtetit dhe ka qënë i martuar dhe nga martesja ai ka lënë edhe një vajzë të quajturën M. H. K., e datëlindjes 21.07.1986.

Nga ana jonë ju kërkua shpjegime Bashkisë Shkodër, se si qëndron ky problem e cila me shkresën e saj me Nr.1987/1 prot datë 21.02.2018, na njofton se në bazë të nenit 54 të Ligjit me Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Këshilli Bashkiak ka për detyrë të vendos emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve të juridiksionit të Bashkisë, dhe se deri tani ky problem nuk është shqyrtuar dhe nuk vendosur akoma.

Në rastin konkret mendojmë se ky problem duhet vlerësuar më shumë nga ana juaj dhe kjo të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionin në fuqi, dhe të vendoset emërtimi i një objekti ose e një institucioni arsimor, në qytetin e Shkodrës në emër të Dëshmorit të Atdheut, H. K. K.

Në nenin 15 të Kushtetutës së RSH, përcaktohet se:

”Të drejtat dhe liritë themelore të Njeriut, janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”.

Po kështu në bazë të kërkesave të nenit 63/3 të Kushtetutës së RSH, thuhet se:

”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, nga administrata publike”. Po kështu duke u bazuar në kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, thuhet se:

”Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit, paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen, dhe për këtë ne ju,

REKOMANDOJMË :

1.Marrjen e masave për shqyrtimin e kërkesës së shtetases M. K., për vendosjen e emërit të “Dëshmirit të Atdheut”, **H. K. K.**, një objekti ose një institucion arsimor në qytetin e Shkodrës.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj, lutemi të na njoftoni me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI